

Data 23.02.2023.

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Ndertim Central Park (Parku Qendor) Faza II”

REF: 60182 - 02-23-2023.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Ndertime tarracash – 45112441-8 etj.

Fondi limit: 33 842 622 (tredhjetë e tre milion e teteqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e njezet e dy) leke pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Librazhd ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formularin e ofertës + preventivin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Nuk aplikohet në këtë rast.**

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Xhiroja mesatare vjetore per nje periudhe maksimumi deri ne 3(tre) vitet e fundit financiare , duhet të ketë një vlerë te pakten sa vlera e parashikuar te kontrates(jo me e vogel se vlera e fondit limit) , pa perfshire vleren e TVSH-se, per te cilin duhet te paraqitet vertetim leshuar nga administrata tatimore. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nqs Operatoret Ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale , ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga AK si me lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve të fundit (2019 – 2020-2021) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektim te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar , neni 43, pika 4, kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negativ ndermjet aktivitet dhe pasivitet.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 ”Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika ”c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", etj.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022 .

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim : Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", te ndryshuar.

3.Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor ne perputhje me LPP dhe RRPP, si më poshtë:

3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlloritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë ne një vlere jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar,
 - Aktin e kolaudimit;
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomik dhe prokurën e posaçme si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit;

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 42, , në rastin e procedurave të hapura, në nenin 47, dhe 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme në një objekt të vetëm të jenë minimalisht në vlerat 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës , që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar, ose për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Mbeshtetur në rendesine e objektit të prokurimit, vlerën e fondit limit të venë në dispozicion , tipologjinë e punimeve të ndertimit si edhe mbështetur në LPP dhe në RRPP.

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

3.2.Liçencat profesionale që duhet të plotësojnë pjesëmarrësit, në varësi të llojit të punimeve për këtë objekt, do të jetë:

N.P – 1 A (Punime gjurmimi në tokë).

N.P – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit).

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.S – 8 A (Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri).

N.S – 10 A (Shtresa dhe mbistruktura speciale).

N.S – 18 A (Punime topogjeodezike).

Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë liçencë).

- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pikat e licencës dhe kategoritë me klasifikimet përkatëse caktohen duke u mbështetur në punimet e parashikuara në preventivin e objektit dhe në vlerën totale të punimeve për secilin kategori.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
---------------------	--	--	---	--

		përkatëse		
N.P – 1	Punime gjurmimi në tokë	Percaktimet preventiv ne	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.P – 12	Punime të inxhinierisë së mjedisit	Percaktimet preventiv ne	A	E kalon vleren 20 milion leke.
N.S – 8	Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri	Percaktimet preventiv ne	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
N.S – 10	Shtresa dhe mbistruktura speciale	Percaktimet preventiv ne	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.
NS - 18	Punime topogjeodezike	Percaktimet preventiv ne	A	Nuk e kalon vleren 20 milion leke.

3.3. Duke vlerësuar llojin , volumet e punimeve dhe afatin e zbatimit të punimeve të vendosur nga projektuesi për këtë objekt, çdo shoqëri pjesëmarrëse, duhet të ketë stafin e nevojshëm për kryerjen e këtij investimi i një punësim mesatar minimumi prej **65 (gjashtedhjetë e pesë)** personave gjithësej (duke përfshirë dhe stafin drejtues dhe teknik), për periudhën **3 muaj te fundit nga data e zhvillimit të tenderit**, të vërtetuar me;

a.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **3 muaj te fundit nga data e zhvillimit të tenderit**.

b.Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **3 muaj te fundit nga data e zhvillimit të tenderit**.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punëtorinë dhe stafin teknikë që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatit të ankimimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, I, j të pikes 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shogeruese të

ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perlllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , Kodi i Punes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit. Komisioni i perlllogaritjes se vleres se fondit limit dhe pergatitjes se dosjes teknike kane analizuar dhe perlllogaritur numrin minimal te punetorese prej 65 punonjesish mesatarisht te dosmosdoshem per realizimin e objektit te prokurimit ne nje afat kohor 4 MUAJ - grafik punimesh.

3.4. Shoqëria pjesëmarrëse duhet të ketë të punësuar staf si drejtues teknik në licencë për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, **të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diploma apo licence profesionale nqs eshte rasti , si dhe të figurojnë dhe në listepagesat e shoqërisë për periudhën 3 muaj te fundit nga data e zhvillimit te tenderit**, stafi inxhinierik si më poshtë :

- Inxhinier ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier mjedisi 1 (një)
- Inxhinier topograf 1 (një)
- Inxhinier elektrik 1 (një)
- Inxhinier arkitekt 1 (një)

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë të paktën 3-muajt e fundit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes se afateve te ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohe ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dipsozitive ligjore në fuqi.

3.5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi profesional nga subjektet e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise , si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise per periudhen tre muaj te fundit nga data e zhvillimit te tenderit , stafin si më poshtë:

- Punonjës teknik ndërtimi 2 (një)
- Punonjes teknik mekanik 1 (nje)
- Elektriçist 2 (dy)
- Betonues 3 (tre)
- Hekurkthyes 3 (tre)
- Karpertier 2 (dy)

- Punëtore ndertimi te thjeshte 15 punonjës

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Dëshmi kualifikimi nga subjektet e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Per punonjesit e thjeshte te ndertimit te paraqiten kontrata e punes e vlefshme si dhe jene te pranishem ne listepagesa per 3 (tre) muajt e fundit.

Sqarim: Në rastin kur O.E disponon një punëtor me më shumë se një kualifikim të certifikuar ky punonjës do të jetë i vlefshëm për të secilin nga kualifikimet që ai disponon.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punëtorin dhe stafin teknik që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatit të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, I, j të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertës të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, të ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 3.5, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

3.6. Operatorët ekonomikë duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës shoqeruar me kontratë të vlefshme pune dhe leje drejtimi përkatëse për 4 (kater) shoferë dhe 4 (kater) manovratore. Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës **3 muaj te fundit nga data e zhvillimit te tenderit**. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 3.6, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi profesional lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

3.8. Pajisjet e domosdoshme për kryerjen e këtij investimi duke u nisur nga lloji dhe sasia e volumeve të punimeve dhe afati i punimeve si dhe kushtet në të cilat do të kryhet ky investim, mjetet e kërkuara janë si vijon:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues , kapaciteti mbajtës minimalisht 20 ton	në pronësi ose me qera	copë	2
2	Kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtes minimalisht 5 ton	në pronësi ose me qera	cope	2
4	Eskavator me goma	në pronësi ose me qera	copë	1
5	Kamioncine deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qera	cope	1
6	Autobetonierë	në pronësi ose me qera	copë	2
7	Autopompe betoni	në pronësi ose me qera	cope	1
9	Fadrome	në pronësi ose me qera	copë	1
11	Autobot uji	në pronësi ose me qera	copë	1
12	Betoniere / vellimi 1 m3	në pronësi ose me qera	copë	3
13	Autovinc	në pronësi ose me qera	copë	1
14	Minieskavator	në pronësi ose me qera	copë	1
15	Minifadroma	në pronësi ose me qera	copë	1
16	Gjeneratore	në pronësi ose me qera	cope	2
17	Tranxhe hekuri	në pronësi ose me qera	cope	1
18	Nivelues per shtresa betoni	në pronësi	cope	2

		ose me qera		
19	Makineri frezimi guri	në pronësi ose me qera	cope	1
20	Makineri per prerje/perpunim guri	në pronësi ose me qera	cope	1
21	Makineri hedhes Betoni	në pronësi ose me qera	cope	1
22	Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL	Pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	Cope	1
23	Fabrike prodhimi te elementeve te betonit e pajisur me QKL	Pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi	cope	1

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, aktin e pronësise, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme),certifikate per transport mallrash brenda vendit nese kerkohet sipas legjislacionit ne fuqi (e vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, aktin e pronësise, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , certifikate per transport mallrash brenda vendit nese kerkohet sipas legjislacionit ne fuqi (e vlefshme) të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Per secilin nga mjetet e kerkuara te paraqiten foto ku te jete e dukshme targat e mjeteve.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar .(Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Per linjen e inerteve , Fabrike prodhimi te elementeve te betonit ne rast se Operatori Ekonomik i disponon ne pronesi duhet te paraqese aktin e pronesise perkatesisht, ne rast se operatori ekonomik nuk i disponon ne pronesi , duhet te paraqese kontrate qeraje apo kontrate furnizimi.

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 65 (gjashtedhjetë e pesë) cope;
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 6 (gjashtë) cope;
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 8 (tete) cope;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) cope
- Fikese zjarri 7 (shtate) cope
- Tabela Sinjalizimi 20 (njetzet) cope

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 "Për miratimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre "(perlloraritja e oreve të Punës si edhe të mjeteve të nevojshme) , bazuar në tipologjinë e zerave të preventivit , analizave perkatëse të zerave të preventivit etj, nga specialistet perkatës të inxhinierë, nga grupi i punës për perlloraritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta teknike të kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre" si edhe nga praktika të mëparshme të ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

3.9.Analizat e çmimeve për çdo zë të preventivit mosparaqitja e tyre përben shkak për skualifikim.

3.10.Cdo ofertues duhet te paraqese grafikun e punimeve te firmosur dhe vulosur nga administratori. Ne rast BO grafikun e punimeve duhet te jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, Vendimi i KM nr. 629, date 15.07.2015 „ Per miratimin e manualit teknik te cmimit te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre“ i ndryshuar, VKM nr. 68 date 15.02.2001 „ Per miratimin e standarteve dhe kushteve teknike te projektimit dhe te zbatimit te punimeve te ndertimit „ te perditesuara , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe te paraqesin analizen teknike per cmimet me ane te te cilave do te ofertojne.

3.11. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- minimalisht 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit për “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”, e dhënë nga një organizem i licënsuar, shqiptar ose i huaj.

- Operatorët ekonomik të kenë në stafin e tyre min. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për dëmet në mjedis”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjes e mjedisit”, i ndryshuar. Për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e dhënë nga një organizem i licënsuar, shqiptar ose i huaj.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine , stafin teknik dhe kerkesat e mesiperme që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te

tyre “(perlllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme, etj. bazuar ne tipologjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhinierë, nga grupi i punes per perlllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta teknike te kualifikimit .

3.7. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001- 2015** (e vlefshme) ose ekuivalente , certifikatën e menaxhimit mjedisor **ISO 14001-2015** (e vlefshme) ose ekuivalente, certifikatën e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë **ISO 45001:2018** (e vlefshme) ose ekuivalente .

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet te jene te të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Çertifikatat e mësipëme kërkohen të jenë të vlefshme.

Ne zbatim te nenit 44 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 autoriteti pranon çdo certifikatë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, neni 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika dhe neni 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

3.12. Operatorët ekonomike duhet te deshmojne plotesimin e kriterëve te vecanta teknike si me poshte vijon:

- Operatori ekonomik duhet te disponoje leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim te mbetjeve qe kane ndikim ne mjedis Kodi III.2.B.”.

- Operatori ekonomik duhet te kete licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.A (1+2) ne mbeshtje te vendimit te Keshillit te Ministrave Ligj Nr. 10431, Date 9/6/2011, VKM Nr. 538, Date 26/5/2009, VKM Nr. 1124, Date 30/7/2008.

3.13. Operatori Ekonomik duhet te caktojë me ane te nje deklarate Drejtuesin Teknik te punimeve i cili duhet te jete i perfshire ne licensen e shoqerise dhe te deklaroje se ai nuk eshte i angazhuar ne kontrata te tjera dhe do te jete i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt.

3.14. Deklarate e Operatorit Ekonomik se oferta e tij eshte ne perputhje me Projektin, specifikimet teknike, kushtet e kontratës, menyren e financimit si dhe te dhenat e tjera ne dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre “(perlllogaritja e oreve të Punës si edhe të mjeteve të nevojshme) , bazuar në tipologjine e zerave të preventivit , analizave perkatëse të zerave të preventivit etj, nga specialistet perkatës të inxhinierë, nga grupi i punës për perlllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta teknike të kualifikimit .

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikojë njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afatëve të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t'i kërkojë ofertuesit fitues të renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për pikat a, b, d, dh, e, h, I, j të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese të ofertes të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: : (Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis Kodi III.2.B). Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet perkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat perkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat perkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

3.13. Operatori Ekonomik duhet te caktojë me ane të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve të cilat duhet të jenë të përfshira në licencën e shoqërisë dhe të deklarohen se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe detyrës ligjore në fuqi.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkangjitur DST.